



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**  
**BORDI ADMINISTRIMIT**

Nr. 2298/3 Prot.

Tiranë, më 21.09 2023

**V E N D I M**

Nr. 60 dt. 21.09 2023

**“PËR**

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.47 DATË 29.06.2023 “PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT PËR KONKURS, REGJISTRIMIT TË FITUESVE, PËR CIKLIN E PARË DHE TË DYTË, TË TRETË TË STUDIMEVE DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR TRE CIKLET E STUDIMEVE, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në Ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH pika 3/g të nenit 3, nenit 6, pika 28,29,30 neni 49, neni 83, neni 85, në Statutin e UST, në Rregulloren e UST, në VKM n. 288 datë 21.05.2018 "Per miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në IPAL, në një program të ciklit të parë të studimeve ose në një program të integruar të studimeve profesionale me kohë të plotë", në Urdhërin e MASR me Nr.495, datë 11.10.2019 "Për hapjen e njësisë kryesore "Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit" në Universitetin e Sporteve të Tiranës", në Urdhërin nr.245 datë 22.07.2020 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në Shkenca të Rehabilitimit”, në Universitetin e Sporteve të Tiranës", në VKM nr.778, datë 26.12.2018; në VKM nr.779 datë 26.12.2018 “Për disa ndryshime në VKM nr. 269, dt.29.03.2017” “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit" të ndryshuar, në VKM nr. 780 datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve, në IAL Publike", në Udhëzimin nr.10 datë 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e Arsimin të Lartë ", në Urdhërin e Ministrisë nr. 355 datë 17.09.2021 "Për hapjen e Programit të studimit të ciklit të dytë “Master profesional në Trajner i Përgatitjes Fizike, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, në Vendimin e Senatit nr.46 datë 07.04.2023 "Mbi miratimin e kuotave të pranimit,për vitin akademik 2023-2024", në Vendimin e Rektoratit nr. 61 datë 22.06.2023, në Vendimin e Senatit Akademik nr.75 datë 26.06.2023, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.47 datë 29.06.2023, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 21.09.2023,

## VENDOSI:

1. Në Tabelën 6, Fakulteti Shkencave të Rehabilitimit të shtohet tabela si vijon:

Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Ciklin e dytë të studimeve, program i pare/dytë i studimeve/	2.000 lekë
---	------------

Emërtimi i Programit Master Profesional	Tarifa për program të dytë studimi (ne lekë) për vitin akademik në lekë/60 kredite në lekë për vitin akademik 2023-2024	
Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport	1460	87600

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, dhe Drejtorja e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek transparenca universitare.

**KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**ARTUR ÇOBANI**

